

- 4.Objektivat e Njesise Publike
- 5.Qellimi i hartimit te Planit Strategjik
- 6.Misioni.Vizioni dhe objektivat strategjik te Sektorit te auditimit.
- 7.Kuadri ligjor I Njesise Publike dhe I sektorit te auditimit te brendeshem.
- 8.Monitorimi dhe rishikimi i Planit Strategjik
- 9.Indentifikimi dhe vlersimi I risqeve.
- 10.Indentifikimi i subjekteve objekt auditimi
- 11.Indentifikimi i sistemeve dhe fushave te llogarise.
- 12.Plani vjetor i auditimit te brendeshem
- 13.Shperndarja e burimeve te Auditimit te Brendeshem
- 14.Nevojat per trajnim per audituesit e brendeshem.

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Planifikimi strategjik është element i menaxhimit strategjik që përcakton prioritetet e Njesise Publike, fokuson përpjekjet dhe burimet, përforcon funksionimin, jep siguri që punonjësit dhe aktorët e përfshirë po punojnë për të arritur objektivat e përbashkëta, krijon një marrëveshje në lidhje me rezultatet, si dhe vlerëson dhe përshtat drejtimin e Njesise Publike ndaj një universi në ndryshim. Planifikimi strategjik kryhet për të gjitha aktivitetet e Njesise Publike.

Ky Plan Strategjik prezanton **objektivat kryesorë**, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Bashkinë Tropoje për periudhën viti 2019-2021.

Plani Strategjik është në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e organizatës të përcaktuara nga Njësia Publike.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin e Auditimit të Brendshëm, Standardet e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës së audituesve të brendshëm dhe Metodologjinë për auditimin e brendshëm në sektorin publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Plani vjetor për auditimin e brendshëm është hartuar duke u mbështetur në Planin Strategjik.

HYRJE

Ky plan strategjik ofron bazen për zhvillimin e Planit Vjetor të aktivitetit të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

Standarti për Planifikimin sipas IIA-së përcaktohet;

Standarti 2010-Planifikimi

Drejtuesi i auditimit duhet të hartojë planet mbi bazë risku për të përcaktuar prioritetet e vlerëtarisë së auditimit të brendshëm, në pajtueshmëri me qëllimet e organizatës.

Gjatë përgatitjes së procesit të planifikimit në fillim audituesit e brendshëm të njesise publike njihen me :

- Strukturën organizative dhe atë të operacioneve të njesise publike.
- Pasqyrat financiare të njesise publike (drejtorinë e financës)
- Kuadrin e përgjithshëm dhe të posaçëm ligjor e rregullator.
- Sistemet dhe proceset e kontabilitetit dhe shkallën e përfshirjes së sistemeve kompjuterike.

Vlerësojnë universin e përgjithshëm të kontrollit.

Misioni i Bashkise Tropoje

Sigurimi i qeverisjes së efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- Realizimin e shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- -Realizimin e shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Objektivat dhe prioritetet e Bashkia Tropoje .

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;
- Një nga objektivat më të rëndësishëm do të jetë garantimi i pastërisë në rrugë dhe në hapësirat publike
- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit e sipërmarrjes;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;

- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- Ndërtimi i veprave të mëdha publike.

Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik

Plani Strategjik është dokument i cili përcakton strategjinë për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkia Tropoje. Kjo strategji u përgatit për periudhën 2019-2021 nga Sektori I Auditimit të Brendshëm miratuar nga Titullari i Njesisë Publike.

Plani strategjik 2019-2021 “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkia Tropoje, ka si qëllim identifikimin e sistemeve, fushave me nivel të lartë rrisht, ku nëpërmjet analizës së tij përcakton mbulimin dhe frekuencën e auditimit.

Plani strategjik përcakton punën që do të ndërmerret nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në Bashkia Tropoje për periudhën e ardhshme 2019-2021.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm është pjesë e veprimtarisë aktuale të Bashkia Tropoje duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin e lartë lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe të administrimit, i cili synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e sistemeve, e fushave kryesore me risk më të lartë.

Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjësi e drejtuesit të Sektorit të Auditit Brendshëm për hartimin dhe dërgimin për miratim tek Titullari I Njesisë Publike dhe dërgimin për informim në Strukturën Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financës.

Sektori e Auditit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazë rrisht, si dhe burimet njerezore të planifikuara në dispozicion të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm

Vizioni, Misioni dhe objektivat strategjike të sektorit të auditimit të brendshëm.

VIZIONI: Te shtojë vlerë nëpërmjet përmirësimit të subjekteve të audituara në njesinë publike duke siguruar përdorimin me dobi, kursim, dhe frytshmeri të fondeve publike.

MISIONI : Misioni i Sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkia Tropoje është që të ndihmojë Titullarin për të arritur objektivat e vendosura për Njesinë publike, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike duke vlerësuar dhe rekomanduar përmirësimin e frytshmerisë së menaxhimit të rrisht dhe proceset e kontrollit të brendshëm, në drejtim të zbatimit të ligjit, rregullave dhe kontroleve të vendosura, vlerësimit të dobisë, frytshmerisë dhe efektivitetit të veprimeve. Dhënien në mënyrë të pavarur të një sigurie të **arsyeshme** për Kryetarin e Bashkia Tropojeme qëllim:

- Përmirësimin e veprimtarisë së Bashkia Tropoje dhe subjekteve vartëse të saj .

- Rritjen e frytshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për sistemet e kontrollit brendshëm për përmirësimin e tyre, për të arritur objektivat e caktuara duke përdorur burimet në mënyrë ekonomike dhe eficiente

Objektivat Strategjike të Sektorit të Auditimit të Brendshëm

- Të përdorë një metodologji Auditimi bashkëkohore që përputhet me standardet e pranuar ndërkombëtare të Auditimit dhe të Njësive Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
- **Sigurimin** për Titullarin e Njësive Publike, të një sistemi vlerësimi eficient të burimeve dhe asetëve në njësine publike për: **Vlerësimin** e sistemit financiar për planifikimin dhe hartimin e buxhetit, **Vlerësimin** që kontrollet e brendshme janë të përshtatshme të parandalojnë gabimet, abuzimet, shpenzimet e tepërta,
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të auditëve përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/technikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut
- Rritja e cilësisë dhe e performancës së auditimeve me shtimin e numrit të cilësisë së zbulimeve si dhe impakt në rritje përsa i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.
- Të raportojë në mënyrë periodike tek Titullari i Njësive publike për misionet e realizuara, problemet e evidentuara dhe rekomandimet në përmbushje të tyre.

Plani Strategjik “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm” përfaqëson një nga veprimtaritë më të rëndësishme për shërbimin e auditimit të brendshëm dhe është një element i kontrollit të brendshëm, i cili hartohet për të siguruar Titullarin e Njësive Publike që të gjithë veprimtaritë dhe operacionet e Njësive Publike, dhe subjekteve të varësisë së saj mbulohen me auditim nga funksioni i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Sекторi i Auditimit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan..

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazën e riskut, si dhe burimet njerezore të planifikuara në dispozicion të Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Sекторi i Auditimit të Brendshëm në Njësine publike është e organizuar si Sektor në varësi të drejtpërdrejtë të Titullarit të Njësive Publike.

Kuadri ligjor në Bashkinë Tropoje :

1. Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

2. Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 10294, datë 1.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik.
6. VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshëm në Bashkinë Tropoje .

1. Ligjinr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
2. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditimit të Brendshëm”;
3. VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
4. VKM nr. 160, datë 2.3.2016 “Përmënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”;
5. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”
6. Manuali i Auditimit të Brendshëm viti 2016

Të gjitha këto do të ndihmojnë njësinë e AB-së të ndërtojë një pamje të asaj që organizata po përpiqet të arrijë dhe të risqëve me të cilat përballlet.

Monitorimi dhe rishikimi i Planit Strategjik

Zhvillimi i Planit Strategjik të AB-së është vetëm hapi i parë i përpjekjeve të njësisë së AB-së për të arritur objektivat dhe përmbushur pritshmëritë e palëve të interesit.

Përgjegjsi i sektorit të AB-së është përgjegjës për ndërtimin e një sistemi efektiv për monitorimin e ekzekutimit të planeve (strategjikë por edhe planeve vjetore).

Kjo është e nevojshme pasi kur identifikohen problemet, duhet të merren masa korrigjuese për të përmirësuar situatën.

Për këtë Plan Strategjik duhet të rishikohet në mënyrë periodike. Faktorët që ndikojnë në shpeshësinë e rishikimit të Planit Strategjik, mund të përfshijnë:

- Ndryshimet në strategjinë e organizatës.
- Shkallën e rritjes së organizatës dhe vlerësimin e pjekurisë së organizimit.
- Ndryshime të rëndësishme në disponueshmërinë e burimeve të aktivitetit të AB-së.
- Ndryshime të rëndësishme në ligjet dhe/ose ndryshime të rëndësishme në politikat dhe procedurat e organizimit.

- Shkallën e ndryshimit në universin e kontrollit të organizatës.
- Ndryshime kyçe në strukturën e menaxhimit të organizatës.
- Vlerësimin se si aktiviteti i AB-së ka kryer në mënyrë sasiore dhe cilësore planin strategjik.
- Rezultatet e vlerësimeve të brendshme/ të jashtme të aktivitetit të AB-së.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Gjate planifikimit mbi baze risku janë mbajtur parasysh tre elementet kryesore të riskut;

- Qe një ngjarje e papritur mund të ndodhë dhe të ketë ndikim në realizimin e objektivave.
- Mundësia që kjo ngjarje mund të ndodhë (propabiliteti)
- Impakti ndikimi negativ në arritjen e objektivave .

Duke ju nënshtruar një analize risku është bërë kategorizimi i zonave me risk në tre nivele, i lartë, i mesëm dhe i ulët.

Analiza dhe renditja sipas riskut, është bazuar mbi:

- Rregjistrin e riskut të njesise publike.
- Eksperienca nga auditimet e mëparshme
- Ndryshimet më të fundit të pësuar në bazën ligjore.

Për realizimin e misionit të Auditimit të Brendshëm me efektivitet dhe efikasitet dhe me qëllim dhënien e një sigurie për Titullarin e njesise publike, rëndësi të veçantë i kushtohet identifikimit të riskut.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2019-2021 janë planifikuar për tu audituar subjekte me risk të lartë e të mesëm duke lënë për tu audituar në periudhat e mevonshme auditime me risk të ulët.

Në planifikimin e nivelit të risqeve jemi bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi, fushat e veprimtarisë, buxhetin, burimet njerezore, periudhën e paaudituar, gjetjet e mëparshme të auditimit.

Planifikimi strategjik përfshin të gjithë sistemet e identifikuar.

Sistemet që vlerësohen se kanë nivel të lartë të riskut, do të auditohen, zakonisht një herë në vit si për shembull:

- Sistemet e menaxhimit financiar, si pagat, sistemi i llogarive, të ardhurat dhe pagesat ,

shërbimet;

- Proceset organizative, si kontrolli buxhetor, menaxhimi i riskut dhe planifikimi financiar sisteme të tjera me nivel të lartë risku, si investimet publike;
- Sistemet për procesin e rekrutimit të punonjesve të rinj.

Sistemet me nivel të ulët të riskut mund të auditohen me frekuencë më të ulët, për shembull, një herë në dy vjet ose edhe më rrallë;

Informacioni i dobishëm sigurohet edhe nga drejtuesit dhe përgjegjësit e subjektit që po auditohet.

Nje planifikim me baze risku do të thote se burimet do të kushtohen fushave ku risku është me i larte ,duke marre ne konsiderate dhe shqetesimet e drejtuesve te njesise publike.

Për këtë arsye vlersimin e riskut do të marrim parasysh dhe regjistrin e riskut të njesise publike. Keshtu qe gjate vlersimit te riskut prioritet do ti jepet dhe nivelit te riskut sipas regjistrin te riskut te organizates.

Rregjistri i Riskut i Njesise Publike

BASHKIA TROPOJE REGJISTRI I RISKUT					
Nr	Pershkrimi i Riskut	Risku para Kontrollit (probabiliteti/im pakti	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	
1	<i>Propozime te reja jane kryer gjate mbedhjes se Keshillit per miratimin e buxhetit, vonojne veprimet</i>	<i>I ulet</i>	<i>Negociata me te gjitha Drejtorite</i>	<i>I ulet</i>	<i>Drej.Ekonomike</i>
2	<i>Shpenzimet I kane tejkualuar te ardhurat</i>	<i>I mesem</i>	<i>Krahasimi mujor per cdo Drejtori. Kontroll I rrepte I Thesarit per cdo Urdher Shpenzimi</i>	<i>I ulet/</i>	<i>Dega e Thesarit</i>
3	<i>Planifikimete bera nga drejtorite nuk eshte ne cdo rast I vleresuara drejt</i>	<i>I mesem</i>	<i>Krahasimi me vitin e kaluar. Shpjegime per ndryshimet</i>	<i>I ulet</i>	<i>Drej.Ekonomike</i>
Paga mujore, sigurimet shoqerore dhe shendetesore					
1	<i>Informacionet per pagat nuk jepen ne kohe, pagat nuk merren ne kohe</i>	<i>I larte</i>	<i>Koordinim me burimet njerezore per te respektuar afatet</i>	<i>I mesem</i>	<i>Drej.Ekonomike</i>
2	<i>Kontributet shoqerore nuk paguhen ne kohe</i>	<i>I mesem</i>	<i>Kontrollohet likujditeti</i>	<i>I mesem</i>	<i>Drej.Ekonomike</i>
Inventari I pronave					

1	Pronat bashkiake nuk kane vlere kontabile	I larte	Vakumi ligjor	I mesem	Drej.Ekonomike
Administrimi I biletave te tregut te lire					
1	Biletat e tregut te lire iu jepen taksidareve pa date.	I larte	Dhenie ditoreve taksidareve te biletave te tregut me date	I larte	Drej.Ekonomike
2	Specialistet e taksave mund te fshehin numrin e tregetareve ambulant	I larte	Krahasami me rezultatet e javes/muajit kaluar.	I larte	Drej.Ekonomike
Pagesat e te PAK dhe Ndhimes ekonomike					
1	Mosmbledhja ne kohen e duhur e keshillit bashkiak per te miratuar ndihmen ekonomike mujore	I mesem	Kerkese drejtorise se Sherbimit social dhe komisionit ekonomik te KB	I ulet	Drej.Ekonomike
Zgjerimi i bazes se taksueshme te bizneseve dhe familjeve					
1	Efektivitetet e punes zyres se taksave dhe bashkepunimi me sektoret	I larte	Takime dhe kerkesa zyrtare ndaj drejtorive te tjera, rritja e mundesive bashkevepruese dhe bashkepunuese per rritjen e nivelit te te ardhurave	I larte	Zyra e Taksave Regjistrimit te Biznesit dhe Tregjeve,
Rritja e performances se administrates					
1	Kapitali njerezor	I larte	Rekrutimi i personelit mbeshtetur ne legjislacionit ne fuqi	I mesem	Sek. Men. te Burimeve Njerezore
2	Mungesa e kualifikimit cilesor	I larte	Percaktimi i indikatoreve te matshem (mesatarja e notave, kualifikime pasuniversitare, punime shkencore)	I mesem	Sek. Men. te Burimeve Njerezore
Rritje e cilesise se sherbimeve publike					
1	Shtimi i hapësirave publike	I mesem	Planifikimi i sherbimit ne keto zona per vitin pasardhes	I mesem	Drejtria e Koordinimit te Sherbimeve Publike
Monitorimi i transportit publik					
	Koopetenca te limituara te policise bashkiake ne	I larte	Japim mendime ne lidhje me nevojat e komunitetit	I mesem	
1	permbushjen e objektivit				

Menaxhimi I pronave					
1	Mospagesa ne kohe e detyrimeve te qirase	I larte	Kerkese ne Keshillin Bashkiak per uljen e mases se qirase per njesite qe ndodhen ne pozicione te disfavorshme	I mesem	Sekt. i Men. te Pronave
Prokurimet publike elektronike					
1	Nenshkrimi I kontrates ne afat e paracaktuara	I larte	Zbatimi I ligjit	I mesem	Sek.Jurid,prok.pub.
Administrimi i kerkesave per leje ndertimi					
1	Legjislacioni ne fuqi	I larte	Selektim i kerkesave per leje ndertimi	I larte	Sek.pla.territorit
2	Dokument pronesie	I larte	Adresim i popullates tek Zyra e Rregjistrimit	I larte	Sek.pla.territorit

Në përgatitjen e Planit Strategjik të AB-së, janë marre parasysh pritshmëritë e palëve të interesuara. Komunikimi me Titullarin e Njesise Publike, drejtoret e drejtorive perkatese pergjegjesit e sektoreve dhe administratorët e njesive administrative.Kykomunikim është i dobishëm për të shtuar efektivitetin e planifikimit të auditimit dhe për të hartuar një plan të aktiviteteve të auditimit, i cili do të përmbushë apo mund të adresojë më mirë nevojat e palëve të interesuara dhe t'u japë përparësi pritshmërive të tyre.

Vlerësimi i nivelit të riskut për Bashkinë Tropoje viti 2019.

Nr	Subjekte për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT			
		Fusha për tu audituar	I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
I	Bashkia Tropoje				
1		Ujesjelles kanalizime sh.a	X		
2		Drejtoria Ekonomike			
3		Sekt. Tatim Taksave	X		
4		Detyrimet e Prapambetura		X	
5		Nd.Ekonomike		X	

6		Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit			
7		Sistemi I Prokurimeve		X	
8		Lejet e Ndertimit		X	
9		Drejtoria e Turizmit dhe Sherbimeve Publike dhe Mbeshtetese			
10		Sekt. i Sherbimeve Publike	X		
11		Inspektoriati I Mjedisit dhe kontrollit te Territorit		X	

Identifikimin e subjekteve objekt auditimi.

Planifikimi strategjik ne Njesine Publike perfshin të gjithë sistemet e identifikuar .

Sektori i Auditimit duhet ti jape përparësi për ato sisteme që do të auditohen, në mënyrë që:

- Sistemet që vlerësohen se kanë nivel të lartë të riskut, do të auditohen me frekuencë të rregullt, zakonisht një herë në vit ne rastin tone Sektori i Finances, sektori i tatim –taksa dhe i menaxhimit te burimeve njerzore.
- Sistemet me nivel të ulët të riskut mund të auditohen me frekuencë më të ulët, për shembull, një herë në dy vjet ose edhe më rrallë(sektori kullin vadites ,pyjor)

Në përcaktimin e frekuencës për sistemet e identifikuara, sektori i Auditit Brendeshem duhet të sigurohet që universi i përgjithshëm i kontrollit ekzistues të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit është përfshirë mjaftueshëm në listën e prioriteteve.

Për identifikimin e subjekteve objekt auditimi janë përfshire të gjitha subjektet që i nënshtrohen auditimit nga sektori i Auditimit të Brendshëm në Njesine Publike për një periudhe 3 vjeçare per vitin 2018, dhe vitet 2019dhe 2020.

Gjatë hartimit të planit strategjik janë marrë parasysh dhe fushat ku do të përqëndrohet auditimi duke ju referuar dhe subjekteve që do të auditohen duke analizuar:

- kohën e auditimit të fundit
- vlerësimin e riskut,
- rezultatet e evidentuara nga auditimet e mëparshme,
- zbatimi I rekomandimeve te lena nga KLSH-ja

Planifikimi strategjik

N r	SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE					
	Viti planifikuar 2019	Niveli i Riskut Viti I pla.	Viti I planif+1 2020	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2 2021	Niveli i Riskut (V. planif.+2)
a	1	2	3	4	5	6
1	Riorganizim I Sherbimit te Furnizimit me Uje te Pijshem,Grumbullimit,Largimit dhe Trajtimimit te Ujrave te Ndotura	I larte	Hartimi ,Miratimi dhe Zbatimi I Buxhetit(perputhshmeria e praktikave,afeteve dhe metodologjise se buxhetit)ne perputhje te plote me bazen rregulloret ne fuqi.	mesem	Administrimi I Aseteve. Dhenia me qira e tyre	I ulet
2	Menaxhimit dhe Realizimi I te Ardhurave nga Sektori I Tatim Taksave	I larte	Sektori I Burimeve Njerezore.Zbatimi I Dispozitave qe rregullojne marredheniet e punes,Pagat dhe Shperblimet	I mesem	Sektori I Finaces dhe Buxhetit.Hartimi dhe mbajtja e Kontabilitetit,Pasqyart Financiare dhe Bilanci Kontabel	I ulet
3	Realizimi I Grafikiut te Detyrimeve te Prapambetura te Institucionit	I larte	Planifikimi I Investimeve Publike ,Detajimi,Dokumentimi I Kerkesave me Fish-projekte,financimi total dhe ai vjetor,Monitorimi dhe raportimi I tyre ne menyre periodike perfshi dhe realizimin e tyre.	I mesem	Arkivimi,Emertimi ,Ndarje dhe ruajtja e dokumen.sipas Dispozitave Ligjore ne Fuqi	I ulet
4	Ndihma Ekonomike dhe pagesat e PAK	I mesem	Llogaritja dhe perdorimi I Fondit te Vecante	I mesem	Sektori I Pronave dhe I Hartografise	I mesem
5	Planifikimi I Shpenzimeve :Percaktimi i Nevojaveper	I mesem	Sektori I Nd.Ekonomike	I mesem	Sektori I Finances dhe	I ulet

	Mallra dhe Sherbime ,Perputhmeria e Nevojave me kerkesat e Programuara nga PBA.		(Njesite Admin.)		Buxhetit.Hartimi dhe Zbatimi I Buxhetit	
6	Zbatimi I Procedurave te Aplikimit dhe te Miratimit per lejet e ndertimit	I mesem	Sektori I Pyjeve dhe kullotave	I mesem	Lejet e Ndertimit	I ulet
7	Sektori I Sherbimeve Publike	I larte	Sektori I Policise Bashkiake	I mesem	Sekt. I Tatim Taksave	I ulet
8	Menaxhimi dhe Zbatimi I Projektev siopas lejeve te ndertimit te marra nga Bashkia nepermjet Portalit E-Lejet ,Ndert.pa Leje	I mesem	Menaxhimi I Fondeve te BE-se ne Fushen e Turizmit dhe Trazhgimise Kulturore	I mesem	Sektori I Sherbimeve Publike	I mesem
9						

Identifikimi i Sistemeve dhe fushave të llogarisë për tu audituar

Me qëllim realizimin e auditimit me bazë risku mbetet i nevojshëm përcaktimi dhe identifikimi i sistemeve.

Për realizimin e identifikimit të sistemeve dhe fushave të llogarisë Sektori i Auditimit të Brendshëm në Njese Publike u mbështet në, objektivat e Njese Publike.

Për 2 drejtorite, sekoret perkates, njesite vartese.

- Sistemit kontrollit të brendshëm, fushat e veprimtarive dhe aktiviteve për çdo structure
- Sistemi i menaxhimit buxhetor/plan biznesin dhe realizimin e te ardhurave dhe shpenzimeve, rezultatin ekonomiko-financiar.
- Sistemi i menaxhimit të aseteve.
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave
- Sistemi i prokurimeve
- Sistemi i pagesave
- Sistemi i kontabilitetit

Auditimi në bazë sistemi mbështetet në sistemin e menaxhimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë nëse ato po funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë efçente për arritjen e objektivave.

Për kryerjen e auditimeve në përshtatje me rrethanat e një auditimi të caktuar, tipeve të auditimit, nga audituesit ne fillim do të bëhet vlerësimi i ambientit të kontrollit të brendshëm, sistemit të informimit dhe të komunikimit, do të perdoren pyetsorë, ekzaminime: të raporteve, deklaratave financiare, vëzhgime direkte, analizat statistikore, eksperiencën personale të auditeve të brendshëm, rezultatet e çdo auditimi më parë, inspektime fizike, sondazhet etj.

Auditimet do të synojnë që nëpërmjet metodave dhe teknikave të auditimit të zbulojnë parregullsitë, gabimet e mashtimet që kanë cënuar pasurinë, efektivitetin e subjektit si dhe kanë ndikuar në saktësinë dhe plotësinë e informacionit financiar.

Frekuenca e auditimeve do të përcaktohet bazuar në zonat me risk më të lartë.

Plani strategjik miratohet nga titullari i njesise publike.

Qellimi i planit strategjik është:

Të ndihmojë titullarin e Njesise Publike dhe titullarët e subjektevevartëse të saj, nëpërmjet kryerjes së auditimeve sipas llojeve si auditim përputhshmerië, financiar, performance dhe të kombinuara, në dhënien e vlerësimitteefektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërisë akteve të brendshme e kontratatme legjislacionin,ruajtja e aseteve, si dhevleresimi i besueshmërisë dhe plotësisë sëinformacioneve operative e financiare.

PLANIFIKIMI VJETOR I AUDITIMIT

Hartimin e planit vjetor 2019 e mbështes në këta tregues:

- Në zhvillimet aktuale të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe Struktura aktuale me të cilën funksionon aktualisht Sektori i Auditit të Brendshëm.

- Prioritet e auditimit e vendosura gjatë vitit 2019, referuar planit vjetor të propozuar dhe kërkesave të titullarit për të kryer angazhim/auditimi.

- Objektivi kryesor për vitin 2019,

- Programimi i llojit të angazhimeve.

-Planifikimi i burimeve për vitin 2019

- Planifikimi i kostos për vitin 2019.

- Planifikimi i nevojave ose kryerja e trajnimeve të stafit.

Planifikimi i subjekteve për auditim është procesi më i rëndësishëm për disiplinimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky plan siguron që elementet e riskut janë adresuar si duhet duke planifikuar si prioritare për auditim, misione mbi bazën e vlerësimit të riskut, gje e cila garanton besueshëm arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Njesise Publike.

Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm është një Program Vjetor Pune. Ai paraqet se si auditimi i brendshëm i përdor burimet e tij gjatë 12 muajve të vitit.

Planifikimi është kryer duke argumentuar të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë vjetore të auditimit, si dhe arsyetimin mbi të cilin është bazuar zgjedhja si risku, frekuenca midis dy auditimeve, shqetësimet e Titullarit te Njesise Publike , prioritetet e Njesise Publike , si dhe rezultatet e eksperiencia e auditimit bazuar në auditimet e mëparshme.

Plani Vjetor mbulon me auditim periudhën nga Janari deri në Dhjetor 2019

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën 2019-2021 i miratuar nga Titullari i Njesise Publike.

Ai përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Detyrat e auditimit për vitin 2019 ndahen në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në sektorin e auditimit të brendshëm. Plani Vjetor do të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhedo të azhrohohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në njesinë publike apo e sektorin e auditit brendshëm, dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga kryetari i njesise publike

Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovohet nga titullari i Njesise Publike.

Gjatë përgatitjes së procesit të planifikimit, audituesit duhet të krijojnë një njohuri të thellë për organizatën që do të auditojnë. Për secilin auditim, audituesit njihen me;

- Strukturën organizative dhe atë të operacioneve;
- Pasqyrat financiare të organizatës (nëse kanë zërat e tyre në buxhet);
- Kuadrin e përgjithshëm dhe të posaçëm ligjor e rregullator që qeveris operacionet e organizatës së audituar;
- Sistemet dhe proceset e kontabilitetit dhe shkallën e përfshirjes së sistemeve kompjuterike.
- Te beje vlersimin e universit të përgjithshëm të kontrollit dhe në veçanti kontrollet për parandalimin e parregullsive, paligjshmërisë dhe mashtrimit.

Për të përftuar një njohuri të mirë dhe informacion të dobishëm, audituesit gjithashtu shohin dokumentet kryesore që ka prodhuar organizata. Këto mund të përfshijnë planet strategjike, raportet vjetore të subjektit të audituar dhe rezultatet e auditimeve të mëparshme .

Plani vjetor i auditimit të brendshëm rrjedh natyrshëm nga planifikimi strategjik i auditimit të brendshëm, ndërsa Planifikimi strategjik rrjedh nga objektivat strategjike të njesise publike. Plani vjetor përputhet me planin strategjik, por mbi të gjitha me drejtimin strategjik të organizatës.

Në rast ndryshimesh në strategjinë e njesise publike, ndryshimet në planin strategjik nuk arrihen të behen, por këto ndryshime përfshihen nga përgjegjësi i Auditit të brendshëm në planin vjetor sapo të vihet në dijeni për to.

Përputhshmëria me qëllimin e organizatës ndihmon sektorin e AB-së të fokusohet vetëm në gjërat e rëndësishme për organizatën dhe menaxhimin. Përputhshmëria e planit të AB-së me qëllimet dhe objektivat e organizatës tregon që aktivitetet e AB-së janë relevante kundrejt objektivave kryesore të organizatës.

Për sa i përket aktivitetit të planifikimit, Standardet IIA sugjerojnë që ;

“drejtuesi ekzekutiv i auditimit duhet të identifikojë dhe të shqyrtojë pritshmëritë e menaxhimit të nivelit të lartë, bordit dhe aktorëve të tjerë në lidhje me opinionet dhe përfundimet e tjera të auditimit të brendshëm”.

Meqë planifikimi strategjik i auditimit jep një vështrim të përgjithshëm rreth aktiviteteve të funksionit të auditimit të brendshëm në tre vitet e ardhshme, auditimi i brendshëm vjetor tregon specifikisht aktivitetet e auditimit të brendshëm që do të kryhen gjatë vitit në vazhdim.

Planifikimi vjetor i auditimit është i bazuar në risk, duke fokusuar angazhimet e auditimit të brendshëm te risqet e rëndësishme dhe duke përjashtuar fushat me risk relativisht të ulët.

Planifikimi vjetor bazohet tek planifikimi strategjik dhe është një aktivitet që ka për qëllim të përkufizojë më mirë aktivitetet e auditimit të brendshëm që do të ndërmerren vitin e ardhshëm. Zakonisht drejtuesi i auditimit të brendshëm është përgjegjës për të zhvilluar një plan të bazuar në risk për përcaktimin e prioriteteve të aktivitetit të auditimit të brendshëm, në përputhje me qëllimet e organizatës.

Audituesi gjatë planifikimit vjetor ka marrë informacion mbi ndryshimet që kanë ndodhur në organizatë. Siç përmendet në planifikimin strategjik, drejtuesi i auditimit të brendshëm dhe audituesit e brendshëm duhet ta njohin mirë organizatën që po auditohet, mjedisin ku operon dhe

risqet kryesore, me qëllim që të sigurohet që procesi i planifikimit fokusohet në fushat e duhura. Kjo mund të bëhet duke shikuar;

- Rishikim i organigramës
- Rishikim i rregulloreve
- Intervista me drejtuesit e drejtorive, sektorëve, njesive vartese, drejtuesit e njesive administrative,
- Audituesit gjithashtu kontrollojnë nëse kanë dalë ligje/rregullore të reja.
 - Diskutojë me menaxhimin e nivelit të lartë.

Është e rëndësishme që të takohet me menaxhimin e nivelit të lartë në lidhje me planin vjetor të auditimit për keto arsye kryesore:

-Duke marrë pjesë në procesin e planifikimit, Titullari i Njesise Publike është më i përfshirë në aktivitetet e parashikuara të auditimit të brendshëm.

-Vlerësimi vjetor i riskut (bazuar në regjistrin e riskut të njesise publike).

-Gjatë planifikimit vjetor audituesit e brendshëm bëjnë rivlerësimin e risqeve, përfshijnë në vlerësimin e riskut të gjithë informacionin e ri dhe të mbledhur në hapat e mëparshëm.

Informacione të tjera përfshihen në planin vjetor përfundimtar:

- objektivat për njësinë e auditimit;
- kriteret për të matur progresin e përmbushjes së objektivit;
- planet për numrin e stafit dhe buxhetin financiar;
- plane rikuperimi në rast se aktivitetet e auditimit nuk janë kryer në kohë sipas planit.

PLANIFIKIMI VJETOR I AUDITIMIT

N r	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Audit me Gjiths ej (4.1+4 .2+4.3 +4.4+ 4.5+4. 6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbime t e konsulenc ës	Grupi i Auditimit (nr.auditue s)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4 1	4. 2	4. 3	4.4	4. 5	4.6	5
1	Ujshelles kanalizime Sh,A	Mos ushtrim i kompetencave te Asamblese se pergjithshme ,Keshillit te Administrimit dhe Administratirit te shoqerise. Mosperputhja e kerkesave te vendit te punes me aftesite dhe eksperiencen e stafit qe sjell nje staf te paqkualifikuar dhe mosrealizim te objektivave te sektorit.	1	1						

		Menaxhimi I funksionimit te sistemit te shitjeve .Zbatimi I procedurave ligjore per veprimtarine ekon.financiare te shoqerise ,sistemi i pagesave ne pergjithesi deklarimet elektronike dhe arketimet nga te tretet.Zbatimi I detyrave te drejtorise teknike per realizimin e objektivit kryesor te shoqerise .Hartimi I projekteve te mirembajtjes rrjetit shperndares te ujit te pijshem dhe kanalizimeve te ujrave te ndotura.								
2	Sektori I Tatim Taksave	Menaxh.dhe Realiz. te Ardhurave nga Sekt.T.Taksave	1	1						
3	Sektori Finaces Buxhetit	Realizimi I Grafikut te Detyrimeve te Prapambetura te Institucionit	1	1						
4	Sektori I Nd.Ekonomike	Ndihma Ekonomike dhe pagesat e PAK	1	1						
5	Drejt.Planifik.dhe Zhvillimit te Territorit	Planifikimi I Shpenzimeve :Percaktimi i Nevojaveper Mallra dhe Sherbime ,Perputhmeria e Nevojave me kerkesat e Programuara nga PBA.	1	1						
6	Drejtoria E Turizmit dhe Sherbimeve Mbeshtetse	Zbatimi I Procedurave te Aplikimit dhe te Miratimit per lejet e ndertimit	1	1						
7	Inspektoriati I	Menaxhimi dhe	1	1						

Mjedisit dhe Mbrojtjes se Territorit	Zbatimi I Projektev siopas lejeve te ndertimit te marra nga Bashkia nepermjet Portalit E-Lejet Ndert.pa Leje													
--------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Shpërndarja e burimeve të AB dhe Kostoja per auditues

Në nivel organizativ Auditimi i Brendshëm funksionon në nivel sektori i përbërë nga një përgjegjes dhe dy auditues.

Auditi i Brendshëm do të mbështetet në burimet njerëzore aktuale për përmbushjen e angazhimeve të veçanta miratuara nga Titullari i njesise publike.

Shpërndarja e burimeve është një aktivitet që fillon me planifikimin strategjik. Drejtuesi i auditimit të brendshëm llogarit përafërsisht numrin e ditëve të punës që nevojiten për të përmbushur objektivat e caktuara në planin strategjik për tre vitet e ardhshme, dhe në mënyrë më të detajuar në planin vjetor.

Në vijim jepet një parashikim i burimeve të auditimit në ditë njerëz bazuar në një bilanc tëmenaxhimit të burimeve të auditimit njerëz dhe ditë pune në dispozicion për vitin 2019.

Llogaritja e buxhetit të auditimit është kryer mbi kalkulime të përafërta duke marrë parasysh të dhënat aktuale mbi numrin e audituesve ne rastin tone 3 auditues si dhe treguesit aktualë mbi pagat dhe shërbimet e tjera, si: energji, kancelari etj. Në bazë të llogaritjes, kosto për person për vitin 2019 me treguesit aktualë është rreth 809 mijë lekë.

Si treguesit e fondit të kohës dhe ato të kostos mund të ndryshojnë nëse ndryshojnë treguesit e ndryshëm gjatë vitit 2019.

Drejtuesi i AB-së bën një llogaritje të thjeshtë të ditëve të punës për person. Ne rastin tone per sektorin e auditimit e kemi me nje person llogaritja eshte sipas tabelës se mëposhtme;

Tabela e burimeve te planifikuara dhe buxhetit te planifikuar

N r	BURIMET E PLANIFIKUARA			N r	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të AB	Ditë për tregues	Përlllogaritj a e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të AB	Plan i
	1	2	3		1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	260	52x5x3	1	Buxheti Gjithsej	809
2	Pushime Vjetore	20	20x3	2	Paga dhe Sig.Shoqërore	763
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	13	13x3	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	45
4	Pushime për arsye shëndetësore	5	5x3	4	Të tjera	0
5	Angazhime në trajnime	5	5x3	5	Numri i Punonjësve	1
6	Angazhime në mbledhje/takime	3	3x3	6	Kosto për Person(1/3	809
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	10	10x3			
	TOTALI	204	612 d/pers			

Nevoja për kualifikimin e audituesve te brendeshem.

Audituesit e brendshëm duhet të kenë njohuri dhe aftësi, të cilat i bëjnë ata të aftë të kryejnë një auditim të brendshëm.

Një auditues i brendshëm duhet të ketë aftësi dhe cilësi profesionale dhe personale të caktuara në mënyrë që të mund të performojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij kur kryen një auditim. Ato kategorizohen në dy grupe kryesore: cilësi personale dhe profesionale.

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr.personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Mbi auditimet e sistemeve te IT	3	gjatë vitit	
2	Mbi auditimet ne fushen e kontabilitetit	3	gjatë vitit	

